



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2828/15 prot.

Datë 06.02.2024

V E N D I M
Nr. 147/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1317/2023, datë 15.12.2023, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83516-10-12-2023, me objekt: “*Blerje pajisje mobilerie, Shkolla e mesme ‘Skënderbeu’ Krumë*”, me fond limit 4,907,576 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK, me NIPT (K21518003F), me adresë: Njësia Administrative Nr.11, Kodër Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati 1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Has, me adresë: Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, Qyteti Krumë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “Erzeni/SH” SHPK, me NIPT (J66902027T), me adresë: Lagjja “Bahçallëk”, Rruga Nacionale Shkodër-Tiranë, Nr. pasurie 17/910, Zona kadastrale 8591, Shkodër,
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e*

*Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 15.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1317/2023, datë 15.12.2023, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83516-10-12-2023, me objekt: “Blerje pajisje mobilerie, Shkolla e mesme ‘Skenderbeu’ Krume”, me fond limit 4,907,576 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 24.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Klame” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 402 prot., datë 31.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 2828/11 prot., datë 02.02.2024, si dhe shkresës nr. 417 prot., datë 01.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 2828/12 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor “Bashkia Has”, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1317/2023, datë 15.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83516-10-12-2023, me objekt: “Blerje pajisje mobilerie, Shkolla e mesme ‘Skënderbeu’ Krumë”, me fond limit 4,907,576 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 24.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 402 prot., datë 31.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 2828/11 prot., datë 02.02.2024, si dhe shkresës nr. 417 prot., datë 01.02.2024, protokolluar me tonën me

nr. 2828/12 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor “Bashkia Has”, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1317/2023, datë 15.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83516-10-12-2023, me objekt: “*Blerje pajisje mobilerie, Shkolla e mesme ‘Skënderbeu’ Krumë*”, me fond limit 4,907,576 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 24.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.

Referuar shkresave të mësipërme, të dorëzuara nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P 1317/2023, datë 15.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, por duhet të publikojë Formularin e Njoftimit të Fituesit Paraprak sipas vendimmarrjes së KPP-së, në vendimin K.P.P 1317/2023, datë 15.12.2023.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor “Bashkia Has”, ka zbatuar vendimin K.P.P 1317/2023, datë 15.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83516-10-12-2023, me objekt: “*Blerje pajisje mobilerie, Shkolla e mesme ‘Skënderbeu’ Krumë*”, me fond limit 4,907,576 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 24.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.
 2. Autoriteti kontraktor, të publikojë Formularin e Njoftimit të Fituesit Paraprak, sipas vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik në vendimin Nr. 1317/2023, datë 15.12.2023.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

